



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 26.04.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha, këshilltar nga OSBE-ja; Dhurata Kryeziu, OSBE; Visar Rushiti, GAP dhe Erxhan Galushi, OSBE.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12.04.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Miratimi i Raportit përfundimtar të Projektligjit nr. 04/L-177, për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- E filloi takimin e radhës së Komisionit, duke kërkuar nga anëtarët pajtimin e tyre për miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u aprovua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12.04.2013

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më **12.04.2013**.

Procesverbalet u aprovuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se raporti është pranuar nga anëtarët e Komisionit dhe hapi diskutimin për raportin vjetor të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Vjollca Krasniqi- Raporti vjetor i punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i pakompletuar, sepse mungon çdo e dyta faqe, dhe krahas një problemi teknik, mungon kronologjia e lidhjes së raportit, prandaj vlerësoi se gjysma e raportit, nuk është e prezantuar. Për këtë arsye propozoi që shqyrtimi i tij të shtyhet për në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Rexhep Selimi- Vlerësoi se raporti i pranuar përmban defekte teknike dhe shqyrtimi i tij mund të bëhet në mbledhjen e radhës së Komisionit, pas pranimit të raportit të plotë.

Fatmir Xhelili- Pajtohem që shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të mbetet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Pasi Raporti vjetor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i pakompletuar, që mund të jetë një gabim teknik, kërkojmë që ai të paraqitet i plotë, në mënyrë që të shqyrtohet dhe procedohet tutje për seancë.

4. Miratimi i Raportit përfundimtar i Projektligjit nr. 04/L-177, për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Kryetari i Komisionit- Falënderoi grupin punues që ka punuar në amendamentimin e Projektligjit për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. Projektligji tani është i gatshëm me amendamentet përkatëse dhe janë bërë të gjitha përgatitjet që të dërgohet në seancë plenare. Më tutje ftoi anëtarët për komente dhe propozoi aprovimin e raportit përfundimtar të Projektligjit nr. 04/L-177, për dërgimin e FSK-së jashtë vendit.

Vjollca Krasniqi- Në raportin e paraqitur me amendamente, kam vërejtur se nga grupi punues janë bërë përmirësime në aspektin gjuhësor. Gjithashtu, disa gabime teknike që janë në të, duhet të përmirësohen.

Kryetari i Komisionit- Çështja e gabimeve teknike në raport do të merren në konsideratë nga ana e lektorëve, por konsideroj se Projektligji për dërgimin e FSK-së jashtë vendit është përpunuar mirë dhe është i gatshëm të procedohet në seancë.

Në këtë pikë të rendit të ditës, kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti i Projektligjit nr. 04/L-177, për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Komisioni, në kuadër të mandatit që ka në mbikëqyrjen e implementimit të ligjeve, si dhe punën e institucioneve që mbikëqyrë, propozoi që për këtë qëllim, të realizohet një vizitë në Drejtorinë e Policisë së Kosovës dhe në Qendrën e Situatave. Më tutje ftoi anëtarët nëse kanë propozime për vizita në institucione që mbikëqyren nga ana e Komisionit.

Rexhep Selimi- Në kuadër të mandatit që ka Komisioni dhe në përputhje me planin e punës, pas realizimit të vizitave të propozuara, do të duhej që të informohet FSK-ja për vizitën që do të bëhet në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe FSK-së, në mënyrë që pas vizitave të propozuara, të vazhdohet me vizitën në FSK, në kuadër të funksionit mbikëqyrës që ka Komisioni.

Kryetari i Komisionit- Për propozimin e bërë nga ana e z. Selimi, tha se mbetet të organizohet në bazë të angazhimeve që ka Komisioni në javën që vjen.

Rexhep Selimi- Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për IPK-në, grupi punues që ka punuar në këtë ligji, është në fazën përfundimtare të mbikëqyrjes së këtij ligji. Ka mbetur të realizohet edhe një vizitë në IPK dhe organizimi i një dëgjimi publik. Prandaj, në dy javët e ardhshme, do të realizohet raporti përfundimtar për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit për IPK-në.

Kryetari i Komisionit- Në javët në vazhdim, në bashkëpunim me IPK-në, do të mund të realizohet debati në Komision për mbikëqyrjen e Ligjit për IPK-në.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.
Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi